

REGJISTRI KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE - MARS 2025

NR. RENDOR	DATA E KËRKESËS	OBJEKTI I KËRKESËS	DATA E PËRGJIGJES	PËRGJIGJE	MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË KËRKESËS	TARIFA
1	03.03.2025	Kërkesë	28.03.2025	 Sqarojmë se,AZHT kryen funksionet e Sekretariat Teknik të KKTU-së, dhe n7 përputhje me VKM-në Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit” , i ndryshuar ka kompetencën për të pranuar, përgatitur dhe administruar dokumentacionin tekniko-ligjor që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Territorit. Në përgjigje të kërkesës Suaj,ju bëjmë me dije se në sistemin elektronik e-leje është depozituar aplikimi... Së fundmi,ju informojmë se AZHT nuk do të vijojë me procedurat e mëtejshme pa u plotësuar i gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka
2	05.03.2025	Kërkesë	11.04.2025	 Referuar kërkesës tuaj,pas verifikimit..pranë AZHT,ju informojmë se nuk është miratuar ende Plani i Përgjithshëm Vendor për..,në të cilën ndodhet pasuria të cilës ju i referoheni. Në vijim ju bëjmë me dije se bazuar në Vendimin Nr.01 datë 30.07.2015 të KKT "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi,deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore",ku ndër të tjera në pikën 2 germa "e" parashikohet se: "Deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore, zonat sipas nenit 45, pika b), të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” , i ndryshuar, autoritetet e zhvillimit të territorit lejohet të japin leje ndërtimi, vetëm për këto raste përjashtimore: e) struktura në funksion të prodhimit, përpunimit dhe distribucionit të produkteve bujqësore dhe blegtorale;". Sa më sipër ju sugjerojmë t'i drejtoheni bashkisë..konform parashikimeve të këtij vendimi,të cilin e gjeni bahskëlidhur kësaj shkrese.	E plotë	Nuk ka

3	06.03.2025	Kërkesë për informacion	13.03.2025	Në lidhje me kërkesën Tuaj të dërguar në adresën elektronike të AZHT, ju bëjmë me dije se Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit është zbardhur. Ky vendim, së bashku me hartën që i bashkëlidhet, janë të aksesueshme për të gjithë subjektet, ashtu sikurse të gjithë Vendimet e tjerë të Këshillit Kombëtar të Territorit, në adresën zyrtare të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit: http://www.azht.gov.al, në rubrikën “Vendime KKT. Në vijim sqarojmë se, referuar Nenit 3 “E drejta e informimit”, pika 4, të Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” (Ligj të cilit ju i referoheni edhe në shkresën tuaj) citohet se : <i>“Informacioni publik, që i është dhënë një personi, nuk mund t’i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjekteve, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji”,</i> Gjithashtu referuar Nenit 17 “Kufizime”, pika 1, shkronja “c”, po të Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, citohet se: <i>“1. E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm :</i> ... <i>c) të drejtën e autorit;</i> <i>Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të kësaj pike, nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji. Pavarësisht nga sa parashikohet në këtë pikë, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.</i> Në zbatim të dispozitës sipërcituar, Agjencia e Zhvillimit të Territorit nuk ka pëlqimin nga titullarët e të drejtave e për këtë arsye nuk mund t’ju vendos në dispozicion dokumentacionin që ka shërbyer për miratimin e lejes sipërcituar, mbështetur edhe në Nenin 8 “Veprat”, pika 1, shkronjat “e” dhe “g”, të Ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, veprat që janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit janë: <i>e) krijimet arkitekturore, që përfshijnë vizatimet, planet, skicat në shkallë të zvogëluar dhe krijimet grafike në projektet arkitekturore.</i> <i>g) krijimet tredimensionale, ilustrimet, listat, hartat dhe vizatimet në fushën e topografisë, gjeografisë dhe shkencës në përgjithësi;</i> Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se gjithashtu referuar Ligj Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, dokumentacioni që ju kërkon duke përmendur dokumentacionin e pronësisë si dhe kontratat e sipërmarrjes, gjithashtu nuk mund t’ju vendosen në dispozicion pasi përmbajnë të dhënat personale.	E plotë	Nuk ka
---	------------	-------------------------	------------	---	---------	--------

4	10.03.2025	Kërkesë për informacion	13.03.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj,..... Ju informojmë,si më poshtë vijon; AZHT,e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i KKT është krijuar me VKM-në Nr.725,datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizmit dhe funksionimit të AZHT" i ndryshuar,dhe në përputhje me Kreun III "Përgjegjësitë dhe detyrat e agjensisë", pika nr.1,e këtij vendimi, ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit tekniko-ligjor që që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU, me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit dhe/apo ndërtimit,për të gjitha tipologjitë e zhvillimeve,shqyrtimi dhe vendimmarrja për të cilat, është kompetencë e KKTU-së. Për sa më lart,nga verifikimi i kryer...për..., nuk evidentoi asnjë aplikim për Leje Zhvillimi/Ndërtimi pranë institucionit tonë.Lutemi t'i drejtoheni insitucionit të Bashkisë..si organi kompetent për miratimin dhe lëshimin e lejes së Ndërtimit.	E plotë	Nuk ka
5	10.03.2025	Kërkesë për informacion për zhvillim në lidhje me zonën.....	17.03.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj,..... Ju bëjmë me dije,si vijon; AZHT,në bazë të Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar është autoritet përgjegjës për zhvillimin e territorit si dhe kryen funksionet e sekretariatit teknik të KKTU.Gjithashtu,referuar po këtij ligji,në nenin 28 të tij,ndër të tjera përcaktohen përgjegjësitë e KKTU: <u>Pika1.KKTU-ja është autoriteti përgjegjës për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për llojet e zhvillimit kompleks,të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit dhe ato që lidhen me çështje,zona,onjekte të rëndësisë kombëtare</u> apo me investime strategjike për interesat e vendit,si dhe për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe ndërtimi për objektet brenda brezit të zhvillimeve të kontrolluara,sipas përkufizimit të ligjit për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare.KKTU-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet në kompetencë të saj . Për sa më lart,referuar kërkesës tuaj,AZHT për të bërë verifikimet përkatëse kërkon nga ana Juaj të na vini në dispozicion hartën treguese dhe koordinata e sakta të pasurisë.....	E plotë	Nuk ka
6	10.03.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të dokumentacionit teknik	17.03.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj..Ju informojmë se: Nëpërmjet shkresave.....Ju është vënë në dispozicion një kopje e njehsuar me origjinalin,të dokumentave të listuara si më poshtë vijon,ku evidentohen në mënyrë të detajuar informacione përshkruese dhe grafike,..... Pjesa tjetër e akteve të cituara në shkresën tuaj nuk disponohet nga AZHT pasi nuk është pjesë e dokumentacionit të nevojshëm ligjor të kërkuar për pajisje me Çertifikatë Përdorimi,sipas Nenit 27/2 të VKM-së nr.408,datë 13.05.2015 "Mbi miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit",i ndryshuar.	E plotë	Nuk ka

7	10.03.2025	Vënie në dispozicion të dokumentacionit	17.03.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj..Ju bëjmë me dije,si më poshtë vijon: Pranë AZHT,si Sekretariat Teknik I KKTU-së,është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve,aplikimi..... Në vijim,referuar Nenit 15 "Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi",të VKM-së Nr.408,datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit",e ndryshuar,parashikohet në mënyrë të detajuar i gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor që duhet të paraqesin aplikuesit për miratimin e lejeve të ndërtimit,ku ndër të tjera janë edhe "...dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim..."(pika 1, shkronja "b"). Sqarojmë se,gjatë shqyrtimit të aplikimeve për leje zhvillimi/ndërtimi,AZHT nuk kryen verifikimin e statusit juridik,origjinës së pronës si dhe mënyrën e regjistrimit të saj,si dhe referuar Nenit 4 paragrafi 2 të VKM-së 408/2015:"Autoriteti i zhvillimit nuk mund të kërkojë vërtetime nga personi i interesuar lidhur me vërtetësinë apo autenticitetin e këtyre dokumenteve apo të dhënave",por konsideron të rregullt dhe komform legjislacionit në fuqi,dokumentacionin e pronësisë që disponohet nga ASHK dhe Drejtoritë Vendore të saj,të cilat janë autoriteti kompetent për lëshimin e tyre....Të gjithë vendimet pas nënshkrimit mund t'i aksesoni në faqen web të AZHT www.azht.gov.al. 	E plotë	Nuk ka
8	11.03.2025	Kërkesë për informacion	25.03.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj të dërguar në adresën elektronike të AZHT, ju sqarojmë se: Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), e cila aktualisht kryen funksionet e Sekretariat Teknik të KKTU-së, është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar. Në mbështetje të VKM-së sipërcituar, kjo Agjenci ka kompetencë <i>pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionin që shqyrtohet në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Territorit</i> t, me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU. Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit në mbledhjen..., me vendimin ... ka vendosur “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin....., në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, vendim i cili është ende në proces zbardhje. Për sa më sipër, në përfundim të procesit të zbardhjes, Vendimin të nënshkruar nga Kryetari i KKT-së, Ministri i Linjës dhe Sekretari i KKT-së mund t’a gjeni të publikuar së bashku me dokumentacionin që e shoqëron, në faqen zyrtare web të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit www.azht.gov.al, në Rubrikën “Vendimi KKT”.	E plotë	Nuk ka

9	17.03.2025	Peticion për kundërshtimin e vendimit për ndërtimin e....	26.03.2025	Në përgjigje të ankesës Tuaj..Ju bëjmë me dije,si më poshtë: Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i KKTU-së, në mbështetje të Vendimit Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar ka kompetencë <i>pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionin që shqyrtohet në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Territorit, me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU</i> . Pranë AZHT,është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik e-leje aplikimi... Në vijim,në përputhje me Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij,KKT,në mbledhjen... Gjithashtu,ju bëjmë me dije se KKTU është organ kolegjal,që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe kryesohet nga Kryeministri.Vendimarrja e sipërcituar është ndërmarrë pas një vlerësimi të përbashkët të anëtarëve të këshillit në zbatim të ligjit nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Sqarojmë se,në lidhje me vendimarrjen si dhe referuar Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar.në Nenin nr.7 "Përgjegjësitë e KKTU",gërma ç),përcaktohet se:"KKTU-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet kompetencë e saj"	E plotë	Nuk ka
10	21.03.2025	Kërkesë	27.03.2025	Në lidhje me kërkesën Tuaj të dërguar në adresën elektronike të AZHT, ju bëjmë me dije se informacionin për mbledhjet KKT e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të web të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit: http://www.azht.gov.al , në rubrikën "Njoftimet e fundit".	E plotë	Nuk ka
11	21.03.2025	Kërkesë			Në proces	Nuk ka
12	25.03.2025	Ankesë			Në proces	Nuk ka
13	27.03.2025	Ankesë/Kërkesë	11.04.2025	Në përgjigje të shkresës suaj...ju bëjmë me dije se: Nga verifikimi i kryer ..pranë AZHT,nuk rezultojnë të ketë vendimarrje nga KKTU për leje ndërtimi/zhvillimi mbi pasurinë... Për sa më sipër,nëse do të ketë një aplikim gjurma e të cilit do të preke pasurinë sipërcituar AZHT si Sekretariat Teknik i KKTU-së do të ketë në konsideratë kërkesën tuaj gjatë shqyrtimit të dokumentacionit tekniko-ligjor,bazuar në Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar,si dhe aktet nënligjore në funksion të tij.	E plotë	Nuk ka
14	28.03.2025	Kërkesë për pezullimin e dhënies së lejes së zhvillimit/ndërtimit	11.04.2025	Në përgjigje të shkresës suaj...ju bëjmë me dije se: Nga verifikimi i kryer ..pranë AZHT,nuk rezultojnë të ketë vendimarrje nga KKTU për leje ndërtimi/zhvillimi mbi pasurinë... Për sa më sipër,nëse do të ketë një aplikim gjurma e të cilit do të preke pasurinë sipërcituar AZHT si Sekretariat Teknik i KKTU-së do të ketë në konsideratë kërkesën tuaj gjatë shqyrtimit të dokumentacionit tekniko-ligjor,bazuar në Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar,si dhe aktet nënligjore në funksion të tij. Duke Ju falenderuar,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka